

Anketa Tremujore e Forcave të Punës


Tremujori III 2025¹

Tiranë, më 10 Dhjetor 2025: Ky botim paraqet treguesit kryesor tremujor të tregut të punës, lidhur me shkallën e punësimit, shkallën e pjesëmarrjes në forcat e punës, papunësisë dhe popullsinë ekonomikisht jo-aktive.

Shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës

- Në tremujorin e tretë të vitit 2025, shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës, për popullsinë 15-64 vjeç është 76,5 %.
 - Krahasuar me tremujorin e tretë të vitit 2024, ky tregues është rritur me 0,6 pikë përqindje;
 - Krahasuar me tremujorin e mëparshëm, ky tregues është rritur me 0,2 pikë përqindje.
- Shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës është 70,2 % për gratë dhe 82,9 % për burrat, duke paraqitur një hendek gjinor prej 12,8 pikë përqindje. Krahasuar me tremujorin e tretë të vitit 2024, shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës për gratë është rritur me 0,7 pikë përqindje, dhe për burrat me 0,3 pikë përqindje.
- Në tremujorin e tretë të vitit 2025, shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës për të rinjtë e moshës 15-29 vjeç është 53,5 %. Ky tregues është ulur me 2,6 pikë përqindje, krahasuar me tremujorin e tretë të vitit 2024, dhe është rritur me 2 pikë përqindje, krahasuar me tremujorin e mëparshëm.
- Për popullsinë 30-64 vjeç, shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës është 85,0 %.

Fig. 1 Shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës për popullsinë 15-64 vjeç, T1/2023 – T3/2025




¹ Rezultatet e Anketës së Forcave të Punës të paraqitura në këtë njoftim për media janë kalibruar duke përdorur popullsinë rezidente sipas rezultateve të Cens të Popullsisë dhe Banesave 2023.

Punësimi

- Në tremujorin e tretë të vitit 2025, shkalla e punësimit për popullsinë 15 vjeç e lart është 58,8 %.
 - Krahasuar me tremujorin e tretë të vitit 2024, ky tregues është rritur me 0,2 pikë përqindje;
 - Krahasuar me tremujorin e mëparshëm, ky tregues është rritur me 0,4 pikë përqindje.
- Në tremujorin e tretë të vitit 2025, shkalla e punësimit për popullsinë 15-64 vjeç është 69,6 %. Krahasuar me të njëjtin tremujor të një viti më parë, kjo shkallë është rritur me 0,4 pikë përqindje, dhe në raport me tremujorin e dytë 2025, është rritur me 0,5 pikë përqindje.
- Shkalla e punësimit për burrat e grupmoshës 15-64 vjeç është 76,6 %, ndërsa për gratë është 62,7 %, duke paraqitur një hendek gjinor prej 13,9 pikë përqindje. Krahasuar me tremujorin e tretë të vitit 2024, shkalla e punësimit është rritur për burrat me 1,1 pikë përqindje, ndërsa për gratë është ulur me 0,3 pikë përqindje.
- Në tremujorin e tretë të vitit 2025, shkalla e punësimit për të rinjtë e moshës 15-29 vjeç është 45,5 %. Ky tregues është ulur me 0,6 pikë përqindje, krahasuar me tremujorin e tretë të vitit 2024, dhe është rritur me 1,7 pikë përqindje krahasuar me tremujorin e mëparshëm.
- Për popullsinë 30-64 vjeç, shkalla e punësimit është 78,5 %.
- Numri i të punësuarve për popullsinë 15 vjeç e lart është 1.178.604, duke shënuar një rritje prej 0,7 %, krahasuar me tremujorin e kaluar. Ndërkohë, krahasuar me të njëjtin tremujor të vitit të kaluar, shënoi një rënie prej 0,6 %.

Fig. 2 Ndryshimi vjetor dhe tremujor i punësimit sipas sektorëve kryesor ekonomik, për popullsinë 15 vjeç e lart (%)



Shkalla e papunësisë

- Në tremujorin e tretë të vitit 2025, shkalla e papunësisë për popullsinë 15 vjeç e lart është 8,1 %.
 - Krahasuar me tremujorin e tretë të vitit 2024, ky tregues ka mbetur i pandryshuar;
 - Krahasuar me tremujorin e mëparshëm, ky tregues është ulur me 0,4 pikë përqindje.
- Shkalla e e papunësisë është 6,8 % për burrat dhe 9,7 % për gratë. Krahasuar me të njëjtin tremujor të vitit 2024, shkalla e papunësisë është rritur me 1,2 pikë përqindje për gratë, ndërsa është ulur me 0,9 pikë përqindje për burrat.
- Në tremujorin e tretë të vitit 2025, shkalla e papunësisë për të rinjtë e moshës 15-29 vjeç është 15,0 %. Ky tregues është ulur me 2,8 pikë përqindje, krahasuar me tremujorin e tretë të vitit 2024 dhe krahasuar me tremujorin e mëparshëm, ky tregues është ulur me 1,3 pikë përqindje.
- Për grupmoshën 30-64 vjeç, shkalla e papunësisë është 7,6 %.

Popullsia ekonomikisht jo-aktive

- Në tremujorin e tretë të vitit 2025, shkalla e inaktivitetit për popullsinë 15-64 vjeç është 23,5 %. Nga totali i popullsisë ekonomikisht jo-aktive në moshë pune:
 - 19,6 % është e angazhuar për të përmbushur detyrat shtëpiake;
 - 9,9 % është në pension ose pension të parakohshëm;
 - 14,9 % është në paaftësi të përhershme për punë;
 - 1,9 % e popullsisë deklaron se nuk po kërkon punë, pasi beson se nuk ka punë të disponueshme, dhe për këtë arsye klasifikohet si të papunë të dekurajuar.
- Shkalla e inaktivitetit për të rinjtë 15-29 vjeç është 46,5 %, prej të cilëve 72,8 % e të rinjtë ekonomikisht jo-aktivë janë të përfshirë në arsim ose trajnim. Ndërkohë, vetëm 0,9 % janë të papunë të dekurajuar.
- Për grupmoshën 30-64 vjeç, popullsia ekonomikisht jo-aktive përbën 15,0 %, ku vetëm 3,0 % e tyre klasifikohen si të dekurajuar, pra individë që kanë hequr dorë nga kërkimi i punës.

Për më shumë informacion dhe për të parë tabelat e detajuara, vizitoni bazën e të dhënave në faqen zyrtare të INSTAT: [Punësimi dhe papunësia](#)

Metodologjia

Anketa Tremujore e Forcave të Punës (ATFP) është një vërtetim statistikor që kryhet pranë familjeve. Objektivi kryesor i saj është të japë informacion mbi situatën e tregut të punës në Shqipëri i cili përdoret për të hartuar politikat e tregut të punës dhe për vlerësimin e efektshmërisë së tyre, si dhe për të kënqur nevojat e përdoruesve të statistikave për të dhëna të përditësuar mbi dinamikën e tregut të punës.

Baza e zgjedhjes e përdorur për ATFP bazohet në të dhënat përmbledhëse për zonat e numërimit sipas Censusit të Popullsisë dhe Banesave 2023. Madhësia e zgjedhjes për ATFP për tremujorin e tretë 2025 është 7.907 familje. Zgjedhja e kampionit bëhet sipas një procedure me dy hapa, ku në hapin e tretë zgjidhen zonat gjeografike me probabilitet përpjesëtimor me madhësinë e zonës së numërimit, dhe në hapin e dytë, brenda secilës prej këtyre zonave gjeografike zgjidhen sipas metodës së zgjedhjes sistematike me probabilitet të barabartë një numër fiks familjesh.

Për ATFP përdoret një strukturë panel e alternuar zgjedhjeje, përmes së cilës një familje e zgjedhur për t'u intervistuar njëherë, mbahet në kampion për pesë tremujorë të njëpasnjëshëm. Intervistat për të njëjtën familje janë planifikuar të kryhen saktësisht pas 13 javëve, kështu intervista e pestë kryhet një vit më pas intervistës së tretë.

Mbledhja e të dhënave në terren bëhet përgjatë gjithë muajve të vitit. Në familjet e zgjedhura anketohen nëpërmjet intervistës së drejtpërdrejtë të gjithë pjesëtarët në moshë 15 vjeç e lart. Në tremujorin e tretë 2025, shkalla e përgjigjes së familjeve ishte 78 %.

Për procedurën e përgjithësimin të të dhënave të Anketës së Forcave të Punës përdoret popullsia e llogaritur mbi bazën e rezultateve të Censusit të Popullsisë dhe Banesave 2023 dhe ngjarjeve demografike (lindjet dhe vdekjet) që vijnë nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile.

Përkufizime

Popullsia në moshë pune është popullsia 15-64 vjeç.

Të punësuar janë konsideruar personat që kanë kryer një punë qoftë dhe një orë kundrejt një page ose përfitimi gjatë javës së referencës.

Janë konsideruar si të punësuar edhe personat që marrin pagë për trajnimin gjatë punës, si dhe personat që kanë munguar përkohësisht në punën e tyre gjatë javës së referencës për arsye: (1) leje lindje, sëmundje, lëndim apo paaftësi e përkohshme dhe presin të kthehen në punë, në shkollim/trajnim të lidhur direkt me punën aktuale; (2) të punësuarit me pagë që kanë munguar në punë për arsye të tjera nga të mësipërmet për të cilët (a) kohëzgjatja e mungesës është tre muaj ose më pak dhe personi nuk është punëtor stinor ose (b) personi merr 50 për qind ose më shumë të pagës; (3) të vetë-punësuarit që kanë ndërmend të rikthehen në biznesin/fermën/praktikën profesionale; (4) punëtorët pa pagesë që presin të kthehen në punë në tre muaj ose më pak. Personat të cilët punojnë në fermën e tyre të vogël, të cilët nuk shesin produktet e tyre, por prodhojnë vetëm për vetë-konsum, janë konsideruar të punësuar.

Java e referencës është java kalendarike nga e hëna në të diel para datës së intervistës.

Të papunë konsiderohen personat që ishin:

- a) pa punë gjatë javës së referencës (as nuk kishin një punë dhe as kryen ndonjë punë (për një orë ose më shumë) kundrejt një page ose përfitimi;
- b) aktualisht të gatshëm për të punuar (brenda dy javëve që pasojnë javën e referencës);
- c) duke kërkuar punë në mënyrë aktive (gjatë periudhës katër javore që përfundon me javën e referencës kishin ndërmarrë hapa specifike për të kërkuar punë me pagë ose për të ngritur një biznes të vetin) ose kishin gjetur një punë që do ta fillonin së shpejti (brenda një periudhe prej të shumtën tre muaj).

Si hapa specifike për të kërkuar punë konsiderohen:

- kontakt me një zyrë publike punësimi për të gjetur punë
- kontakt me një agjenci private punësimi për të gjetur punë
- aplikim direkt pranë ndonjë punëdhënësi
- kërkuar miqve/shokëve, të afërmve, sindikatave etj,
- vendosur ose përgjigjur lajmërimeve në gazeta
- studiuar lajmërimet në gazeta
- marrë pjesë në një test apo intervistë
- kërkuar për tokë, godinë ose pajisje
- aplikuar për leje, licenca ose burime financiare

Forca e Punës përfshin personat e punësuar dhe të papunë.

Popullsia jo-ekonomikisht aktive përfshin të gjithë personat të cilët nuk janë klasifikuar si të punësuar ose të papunë (pra, nxënës/studentë, shtëpiakë, në pension, të paaftë, të papunë të dekurajuar).

Shkalla e punësimit është raporti i të punësuarve 15-64 vjeç kundrejt popullsisë në moshë pune.

Shkalla e papunësisë është raporti i të papunëve kundrejt forcës së punës.

Shkalla e pjesëmarrjes në forcën e punës është raporti i forcës së punës kundrejt popullsisë në moshë pune.

Notë shpjeguese mbi treguesit kryesorë të tregut të punës

Shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës dhe shkalla e punësimit llogariten për popullsinë e moshës 15 deri në 64 vjeç. Ndërsa shkalla e papunësisë llogaritet për popullsinë ekonomikisht aktive (ndryshe forca e punës) të moshës 15 vjeç e lart. Shkallët e punësimit dhe të pjesëmarrjes në forcat e punës të llogaritura mbi popullsinë 15 vjeç e lart ndikohen nga përfshirja e personave në pension në emërues dhe kështu janë më pak kuptimplotë sesa shkallët e llogaritura për popullsinë e moshës 15-64 vjeç. Ndërsa, në llogaritjen e shkallës së papunësisë për popullsinë 15 vjeç e lart, në emërues kemi popullsinë ekonomikisht aktive, e cila përfshin personat e punësuar ose në kërkim aktiv të një pune dhe të aftë për punë, dhe si rrjedhojë ky tregues nuk ndikohet nga popullsia mbi moshën e pensionit.

Cilësia e statistikave të tregut të punës

Rezultatet e Anketës së Forcave të Punës të paraqitura në këtë njoftim për media janë kalibruar, duke përdorur popullsinë rezidente sipas rezultateve të Censurit të Popullsisë dhe Banesave 2023.

Të dhënat e paraqitura në këtë botim janë rivlerësuar, duke filluar nga tremujori i dytë 2023, deri në tremujorin e tretë 2025. Treguesit e Tregut të Punës do të jenë objekt i revizionimeve të mëtejshme.

Treguesit kryesorë të tregut të punës vlerësohen nga Anketa Tremujore e Forcave të Punës. Anketa është bazuar në një zgjedhje probabilitare prej 7913 njësisë ekonomike familjare. Zgjedhja e njësisë ekonomike familjare është bërë e tillë që të sigurojë vlerësime sa më të sakta për treguesit kryesorë të tregut të punës. Pra, nga anketa mund të sigurohen vlerësime dhe jo shifra ekzakte për numrin e të punësuarve dhe të papunëve. Për çdo vlerësim që merret nga anketa llogaritet varianca e zgjedhjes për të tretë se si do të ndryshonte vlerësimi nëse do të kryeshin zgjedhje të ndryshme të rastit me të njëjtin vëllim për të njëjtën periudhë, në vend të një zgjedhjeje të vetme. Kjo na lejon që të përcaktojmë kufijtë brenda të cilëve duhet të gjendet vlerësimi (që në terminologjinë statistikore njihet si intervali i besimit).

Në përgjithësi, sa më e vogël të jetë vlera e devijimit standard relativ të një vlerësimi aq më i lartë është niveli i saktësisë së vlerësimit. Në tabelën 4 paraqiten devijimi standard relativ dhe intervali i besimit për treguesit kryesorë të tregut të punës për popullsinë 15 vjeç e lart.

Tab. 4 Devijimet standarde të përgjithshme të zgjedhjes për treguesit kryesorë të tregut të punës

	Numri i personave në punësim	Shkalla e punësimit si përqindje ndaj popullsisë	Numri i personave të papunë	Shkalla e papunësisë si përqindje ndaj forcës së punës
	Grupmosha: 15+	Grupmosha: 15+	Grupmosha: 15+	Grupmosha: 15+
VLERËSIMI	1.178.604	58,78	104.421	8,14
CV	0,02	0,01	0,06	0,06
SE	223,0	0,01	67,0	0,01
CI *	(1.178.167-1.179.041)	(58,76-58,8)	(104.290-104.552)	(8,12-8,16)

(*) për nivelin e besueshmërisë 95 %

Shkalla e papunësisë për nivelin e besueshmërisë 95 % gjendet mes vlerave 8,12 % dhe 8,16 % dhe ka një devijim standard 0,01 %. Devijimi standard për përpjesën e popullsisë 15+ vjeç në punësim është 0,01 % dhe për nivelin e besueshmërisë 95 %, vlerësimi për shkallën e punësimit gjendet mes vlerave 58,76 % dhe 58,8 %.